



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2714/3 prot.

Datë 07.11.2023

V E N D I M
Nr. 1132/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.11.2023, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr.2714/2 prot., datë 07.11.2023 e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-85354-10-25-2023, me objekt “Furnizim – Vendosje për pajisjen mjekësore EKO, për PAI-in Infektiv” me fond limit 4,083,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK me NIPT J61827062F dhe adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, pallati 53,Ap.6B
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë me adresë: Rruga e Dibrës Nr. 372, Tiranë
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “*Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-85354-10-25-2023, me objekt “Furnizim – Vendosje për pajisjen mjekësore EKO, për PAI-in Infektiv” me fond limit 4,083,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

II.2. Në datën 06.11.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është paraqitur ankesa me nr.2714 prot., e operatorit ekonomik “Biometric Albania” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Me datën 07.11.2023 protokolluar me tonën me nr. 2714/2 prot., datë 07.11.2023 me objekt “Tërheqje nga ankimimi” operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK ka paraqitur pranë KPP-së kërkesën për tërheqje nga ankesa për procedurën e prokurimit të sipërcituar duke u shprehur se: *“Me ane te kesaj shkrese, bazuar ne Nenin 117 te Ligjit Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, deklarojme se terhiqemi nga Ankesa Nr. 2714/2023 Prot. e dates 06.11.2023 mbi proceduren e prokurimit “Furnizim — Vendosje për pajisjen mjekësore EKO, për PAI-in Infektiv” - REF-8535410-25-2023, me fond limit 4 083 333,33 (katër milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) Lekë Pa Tvsh, zhvilluar nga autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.*

Arsyet e kesaj terheqje lidhen me faktin se autoriteti kontraktor Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka paraqitur ne sektorin e prokurimit elektronik Shtojcen nr. 1 date 07.11.2023 (NJOFTIM PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT), shtojce ne te cilen eshte pasqyruar modifikimi i kriterëve per te cilat shoqeria jone ka bere ankesen.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-85354-10-25-2023, me objekt “Furnizim – Vendosje për pajisjen mjekësore EKO, për PAI-in Infektiv” me fond limit 4,083,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të

ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me ankesa me nr.2714 prot., datë 06.11.2023 për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-85354-10-25-2023, me objekt “Furnizim – Vendosje për pajisjen mjekësore EKO, për PAI-in Infektiv” me fond limit 4,083,333.33 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 14.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Biometric Albania” SHPK
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri